



*DOKUMENT STRATEGJIK I POLITIKAVE TË INDUSTRIË
JOSHQIMORE*

(2016-2025)

TIRANË, SHTATTOR 2016

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT STRATEGJIK

Termet dhe referencat

Vështrim i përgjithshëm i Dokumentit të Strategjisë për Industrinë Joushqimore 2016-2025

PJESA I

HISTORIKU DHE SITUATA MBI TË CILËN MBËSHTETET DOKUMENTI STRATEGJIK

1. Metodologjia dhe të dhënat e përdorura
 - 1.1. Rëndësia e industrisë joUshqimore
2. Zhvillimi industrial – treguesit makroekonomikë për periudhën 2009 – 2015
 - 2.1. Analiza strukturore dhe e shpërndarjes rajonale e industrisë.
 - 2.2. Kontributi në PBB, punësimi
3. Treguesit aktuale të industrisë joushqimore
 - 3.1. Ecuria e industrisë përpunuese
4. Institucionet dhe organizatat që lidhen me industrinë joushqimore
5. Kuadri ligjor

PJESA II

KUADRI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E INDUSTRIËS JousHQIMORE

6. Vizioni, qëllimet dhe objektivat strategjike për industrinë joUshqimore, 2016-2025
 - 6.1. Qëllimet për zbatimin e strategjisë
 - 6.2. Objektivat kryesore për zhvillimin e industrisë joUshqimore
 - 6.2.1. Objektivat ekonomike
 - 6.2.2. Objektivat zhvillimore
 - 6.3. Analize e prioriteteve zhvillimore për secilën degë të industrisë

SHTOJCA

Termet dhe referencat

Shkurtime

BE	-	Bashkimi Evropian
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
SKZHI	-	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
PBB	-	Prodhimi Brendshëm Bruto
SKZHI	-	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
BAT	-	Best available techniques (Teknika më të mira të disponueshme për aplikim)
QKL	-	Qendra Kombëtare e Licensimit
QKR	-	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
QKB	-	Qendra Kombëtare e Biznesit
INSTAT	-	Instituti i Statistikave
MEI	-	Ministria e Energjise dhe Industrise
MZHETTS	-	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes
MF	-	Ministria e Financave
MM	-	Ministria e Mjedisit
MMSR	-	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MIE	-	Ministria e Integritetit
MBZHRAU	-	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
MT	-	Ministria e Transportit
MD	-	Ministria e Drejtësisë
EITI	-	Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
VKM	-	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZRPP	-	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
NVE Rev.2	-	Nomeklatura e veprimtarive ekonomike sipas INSTAT.

Referenca

Burime nga QKL për listën e veprimtarive të licencuara në fushën e mjedisit

Burime nga INSTAT për eksport-import etj te sektorëve sipas fushave

Të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Të dhëna nga ish METE për privatizimin

Dokumenti strategjik i vitit 2004 për industrinë jo ushqimore

Të dhëna nga disa subjekte mbi bazë anketimi

Dokumenta strategjik te MZHETTS, M.Mjedisit, Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

Nga Ministria e Financave dhe Doganat

Vështrim i përgjithshëm i Dokumentit Strategjik për politikat në Industrinë Joushqimore 2016-2025

Vendi ynë disponon realisht burime natyrore optimale respektivisht për frymë popullsie krahasuar me statistikat rajonale por edhe atyre botërore (në disa burime natyrore me vlere për ekonominë), pozicion të mirë gjeostrategjik, popullsi të re dhe me nivel arsimor në rritje, krahas trashëgimisë së një tradite në disa sektorë të industrisë Jo Ushqimore. Në këto kushte, një orientim me optimal për zhvillim, duke patur në konsideratë edhe një shpërndarje me të mirë në rajonet e vendit, krijon mundësi për zhvillim harmonik e të qëndrueshëm.

Roli dhe rëndësia e industrisë Jo Ushqimore, është gjithnjë dhe më efikas, pasi është një kontributore me peshë në të ardhura në buxhet, PBB, eksport, punësim etj përveç fakti se produktet e saj kanë nevoja jetike për zhvillimin e një vendi.

Ky dokument bazohet në programin e qeverisë ku merr në analizë e përcakton prioritetet në drejtim të:

- Rritjes së prodhimit vendas dhe nxitjes së eksporteve
- Rritjes së shkallës së përpunimit në vend e burimeve natyrore si kromi, bakri etj duke siguruar dalje në eksport me produkte finale konkurruese në tregun rajonal e me gjere.
- Nxitjen e politikave që rrisin prodhimin, punësimin etj
- Nxitjen e politikave të cilat nëpërmjet investimit aplikojnë teknika më të avancuara shoqëruar me rritje efikasiteti, ulje kostoje e përmirësim të impaktit në mjedis.
- Administrimin e mbetjeve industriale (metale, plastike, leter, druri etj, e nxitje e riciklimit të tyre
- Rritje e partneritetit publik – privat, nëpërmjet konsulencave, takimeve, thithjes së mendimeve për problematika të ndryshme me interes reciprok etj.
- Rritjen e shkallës së bashkëpunimit jo vetëm me aktore të biznesit por sidoemos edhe qarqet akademike në studime e rivlerësime të karakterit tekniko-ekonomik për fusha të caktuara të industrisë jo ushqimore, në funksion të politikave të nevojshme në shërbim të zhvillimit të sektorëve prioritarë me mundësi potenciale konkurruese rajonale e më gjërë.

Dokumenti merr referim edhe te politika industriale të BE-se, si dhe ato Direktiva që prodhojnë detyrime prej pjesëmarrjes së vendit tonë në organizma bashkëpunimi rajonal e më gjerë.

PJESA I

HISTORIKU DHE SITUATA MBI TË CILËN MBËSHTETET DOKUMENTI STRATEGJIK

1. Metodologjia dhe të dhënat e përdorura

Ky dokument është bazuar në disa modele të strategjive të institucioneve të tjerë, të disa vendeve të rajonit e më gjerë, duke patur në fokus Strategjinë e industrisë jo ushqimore, miratuar me VKM Nr.269, datë 23.04.2004, si dhe duke sjellë në vemendje edhe problematikën e krijuar nga zhvillimi industrial në vendin tonë gjatë periudhës 2005 deri 2015.

Strategjitë, të cilat kanë shërbyer si referenca janë Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI, II), Strategjia sektoriale të MZHETTS (Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020), MMSR (Strategjia Kombetare për punësim dhe aftësi 2014 -2020), MM (Strategjia Kombetare për Cilesine e ajrit), si dhe e disa vendeve të rajonit e BE-së, konkretisht e Kroacisë, Maqedonisë dhe Kosovës.

Janë patur në konsideratë edhe politikat e BE-se për industrinë në shekullin e 21-te, të Komisionit European për strategjinë e zhvillimit të vendeve të Europës Juglindore periudha 2010 deri 2020. Orientimi i metodologjisë së përdorur ka synuar arritjen e qasjes së integritetit të politikave me qasjen e Bashkimit Evropian.

Gjatë procesit të hartimit të dokumentit është synuar përfshirja e të gjithë aktorëve që operojnë në fushën e industrisë joushqimore dhe, në funksion të këtij qëllimi, janë ftuar në takime konsultuese bizneset sipas fushave respektive, për të dhënë sugjerimet dhe kontributin e tyre lidhur me zhvillimin e industrisë si dhe për përmirësimin e instrumenteve rregullatore për mbarëvajtjen e ecurisë së aktiviteteve prodhuese.¹

(¹) **Shënim:** Është kërkuar mendim mbi 100 subjekteve kryesore sipas degëve të industrisë Jo Ushqimore në formë pyetësori në vitin 2014, dhe më pas organizuar takime konsultative me disa prej tyre në MEI (si Ind. çimentos, Gomë-plastikes, pasurim minerali bakri, ind. drurit, prodhim çeliku etj). Ndërkohë në vitin 2015 kemi kërkuar mendim Konfindustrisë dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

Është shfrytëzuar eksperiencia nga vende të rajonit, Kosovë dhe Maqedoni, për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve që merren me politikën dhe monitorimin e promovimin e industrisë, kuadrin ligjor, hartimin e dokumenteve strategjike.

Përveç kësaj është kërkuar ndihma e UNIDO-s, organizatë ndërkombëtare me eksperience në përgatitjen e dokumenteve strategjik në disa vende të botës.

Të dhënat e përdorura

Për të marrë të dhëna për veprimtarinë si dhe opinionet e sugjerimet e subjekteve operatore në fushën e industrisë jo ushqimore lidhur me klimën e biznesit, e indikatorë të tjerë me të cilën monitorohet veprimtaria ekonomike është aplikuar forma e pyetësorit dhe anketimi i subjekteve dhe organizatave, si: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Konfindustria, Këshilli i Industrisë së Veshjeve.

Bazë për këtë dokument ishte krijimi i një bazë të dhënash për inventarin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari industriale, të cilat janë pajisur me leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit e të regjistruara nga QKL (tashmë QKB), dhe të dhëna nga institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, QKR (tashmë QKB), INSTAT.⁽²⁾

1.1 Rëndësia e industrisë Jo Ushqimore

Pjesë e industrisë Jo Ushqimore janë sektorë që realizojnë përpunimin e burimeve minerare metalike dhe jo metalike, përpunime të lendeve të para që lidhen me produkte të tilla si lekurë-këpuca, tekstil – konfeksione, gomë – plastika, industria kimike, industria e përpunimit të metaleve dhe riciklimit të disa mbetjeve metalike, plastike, drurit etj.

Zhvillimi i kësaj industrie shoqërohet me kontribute të rëndësishme në ekonominë e vendit, maksimizim i vlerave të burimeve minerare dhe aseteve të tjera që disponon vendi, nëpërmjet

(2) Te dhëna me të detajuara dhe analitike jepen në Shtojcën e këtij Dokumenti, si dhe elemente të tjerë shtese që do të jenë pjesë e tij pas miratimit duke i vene edhe në Web-in e Ministrisë.

rritjes të shkallës së përpunimit në vend, rritje të ardhurash në eksport, PBB, rritje të ardhura direkte në buxhetin e shtetit (nga tatim fitimi, renta etj), nivel me të lartë punësimi etj.

Diapazoni i kësaj industrie është i gjërë dhe lidhet jo vetëm me disa sektorë të ekonomisë, por ka një rol të madh në furnizimin e tregut vendas me produkte të cilat përdoren në industri të tjera apo edhe direkt për konsum.

Përmirësimi i teknologjisë, zbatimi i kërkesave dhe standardeve për sigurinë dhe cilësinë e produkteve, ulja e kostos, konkureshmeria nepermjet sofistikimit janë disa prej kriterëve që e bëjnë më konkuresh ketë industri, jo vetëm perballe presionit në rritje nga prodhues vendor, për të zënë një pozicion të favorshëm në tregun vendas, por edhe si mundësi eksporti të mallrave dhe produkteve të saj.

2. Zhvillimi i industrisë Jo Ushqimore sipas degëve të saj dhe disa tregues makroekonomik.

Periudha pas viteve 1990 e deri në fund të vitit 2015 është karakterizuar nga një ecuri e disa sektorëve, si ai i prodhimit të materialeve të ndërtimit, industria e konfeksioneve dhe prodhimit të këpucëve në marrëdhëniet e tipit përpunimit aktiv (fason), grumbullim e riciklim pjesor i mbetjeve metalike, përpunim minerale metalike si kromi, përpunimi i metaleve kryesisht fokusuar në prodhimin e elementeve prej duralumini pjesë e lidhur me industrinë e ndërtimit.

Njëkohësisht vihet re një zhvillim disi kaotik e jo i mirë strukturuar e administruar sa i takon elementeve që lidhen me planifikimin e territorit, apo lidhja organike e veprimtarive në funksion të burimeve të lëndës së parë etj. Ndikim të madh në këtë zhvillim ka patur edhe lëvizja kaotike e popullsisë duke u përqendruar në zonat urbane e kryesisht Tiranë, Durrës, Lezhë.

2.1 Analiza strukturore dhe shpërndarjes rajonale e industrisë, kontributet në PBB,eksport dhe punësim

Përbërja strukturore e industrisë

Sipas të dhënave rezulton se peshën kryesore në numrin e veprimtarive e zë industria e prodhimit të materialeve të ndërtimit, e cila është e lidhur me një përhapje të madhe të industrisë së

ndërtimit rrjedhojë e një nevojë për strehim, por jo mirë kontrolluar prej fenomenit të lëvizjeve të popullatës në emigracion e në zonat urbane.

Ndërkohe zhvillim ka marre edhe veprimtaria e tekstil-konfeksioneve, lëkure këpucëve, si dhe punimet e drurit dhe letrës, edhe këto të lidhur me faktorët e punësimit kryesisht nga investitorë të huaj me skemën e prodhimit sipas modelit perpunimit aktiv, apo punë me mall porositësi.

Me poshtë është paraqitur në tabelë, struktura sipas degëve e numrit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari industriale e janë të regjistruara në QKL (QKB) për pajisjen edhe me lejen e mjedisit.

Numri i subjekteve sipas grup degëve

Nr.	Emërtimi i Veprimtarisë	Kodi sipas NVE Rev.2	Deri në fund 2013	%	Totali deri në fund 2015	%
1	Tekstil konfeksione	13,14	157	19.45	168	12.62
2	Lëkure Këpuca	15	38	4.71	71	5.33
3	Prodhim material Ndërtimi	23	244	30.24	444	33.36
4	Druri dhe letra	16,17	146	18.09	303	22.76
5	Riciklimi	38	52	6.44	95	7.13
6	Goma plastika	22	68	8.43	107	8.04
7	Industria kimike	20	30	3.35	65	4.88
8	Industria e punimit te metaleve	25,28	56	6.94	58	4.36
9	Metalurgjia	24	19	2.35	20	1.52
	Shuma		810	100.00	1331	100.00

Shënim: Burimi nga QKL, subjekte te licencuara për leje mjedisore deri 2013 dhe 2015

Shpërndarja rajonale

Në ecurinë e deritanishme të veprimtarive industriale, bie në sy ajo e përqendrimit të një numri të madh veprimtarish në zonat urbane, ku vendin e parë e zë Tirana, me rreth 39 % të totalit në punësim dhe 28 % të numrit të subjekteve, pasuar nga Durrësi me 22 % etj. ⁽³⁾

2.2. Kontributi ne PBB

Të dhëna për kontributin e industrisë për frymë popullsie (vlera e PBB/banorë në \$) dhe krahasimi me vendet e rajonit, tregon se Shqipëria radhitet e parafundit në 12 Shtete të rajonit, duke lenë pas vetëm Kosovën. Vendin e parë e mban Greqia me 22350 \$/banor, ndërsa Shqipëria 4087 \$/banorë, ndërkohe që Maqedonia e 10-ta arrin 4850\$/banorë.

³ Shih te dhenat ne shtojcen e ketij dokumenti

Ky tregues reflekton nevojën për një rritje të efikasitetit të degëve të industrisë jo vetëm në strukturë, por edhe mënyrën e funksionimit të saj nga shumë e fragmentuar (njësi të vogla) në riorganizim në njësi më të mëdha tipi i bashkimeve. Si rrjedhojë, kërkohet rritje e performancës në drejtim të nivelit sasior e cilësor, shoqëruar me ulje të kostos të prodhimit, si faktorë bazë në konkurshmërinë me disa prej këtyre vendeve, ku një peshë ka veprimtaria industriale.

Kontributi në qarkullim mallrash

Të dhëna për qarkullimin vjetor në milion lekë sipas degëve (periudha 2010-2013), tregojnë se pjesa e mallrave që sigurohen prej veprimtarive të industrisë përpunuese (jo ushqimore) arrin një kontribut prej 138.156 milionion leke (mesatare e tre viteve) ose rreth 53,84 % ndaj total industrisë, e këtu tekstil – konfeksione dhe lëkurë - këpuca zë rreth 28 % ndaj totalit.

Për vitin 2014 nga sektorët e industrisë jo ushqimore kemi kontribut në eksport me rreth 148.000 milion lekë, ndërsa në vitin 2015 me 151.354 milion lekë, me një rritje prej 9.6 % krahasuar me mesataren e periudhës 2010-2013

Kontributi i industrisë në punësim

Nga rreth 40.494 punonjës (viti 2013) totali i punonjësve të subjekteve të analizuara sipas QKL, dhe administrates tatimore, peshën kryesore në punësim e zëne Tekstil-Konfeksione me rreth 43 % të numrit total të punësimit, pasuar me industrinë e lëkure këpucëve dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit. Rreth 64 % të punonjësve e përballojnë industria e tekstil-konfeksione dhe lëkure këpucëve, apo rreth 26 mijë veta, natyrisht pretendohet se ka akoma një numër me të madh, por këto të dhëna janë sipas tatimeve.

Në shpërndarjen sipas qarqeve, rezulton se rreth 60 % është e përqendruar në Tiranë dhe Durrës, rrjedhojë e faktorit demografik si dhe infrastrukturës optimale për lëvizjen e mallrave, në marrëdhëniet doganore e portale për import eksport.

Shpërndarja demografike e subjekteve sipas numrit të punonjësve, është e tillë ku rreth 44.4 % e tyre janë me 1 deri 10 të punësuar, dhe 28,4 % 11 deri 50 të punësuar, ndërsa mbi 500 janë vetëm 7 subjekte ose rreth 1 %.

Të dhëna të punësimit sipas aktiviteteve ekonomike dhe kontributi i industrisë (2013-2014)

Nr	Aktiviteti ekonomik	Punësimi		Ne %	
		2013	2014	2013	2014
1	Bujqësia	442.787	442.825	44.60	42,7
2	Industri përpunuese, total*	75.747	89.187	Krr.60	8,6
3	Ndërtim	72.436	66.372	Krr.30	6,4
4	Industri nxjerrëse, energji, gaz dhe furnizim me ujë	21.795	24.890	Shk.20	2,4
5	Tregti, transport, hoteleri, shërbime biznesi etj.	211.987	234.376	21.40	22,6
6	Administrim publik, shërbime sociale etj.	163.545	174.226	16.50	16,8
7	E papërcaktuar	3.731	5.185	0.40	0,5
	Totali	992.029	1.037.061	100.00	100

*Industria jo ushqimorë ka gjithsej 40 494 punonjës, ose 4.08 %. Burimi sipas INSTAT

Në sektorët e veprimtarisë së industrisë së produkteve jo ushqimorë, zënia me pune në raport me totalin në shkallë vendi është në nivele të ulëta rreth 4 – 4,6 %. Kjo tregon qartë për rritjen e shkallës së përpunimit të lëndës parë vendase, si ato natyrore edhe të tjera si lëkura, etj. sepse nëse sigurohet cikli i plotë përpunues rritet vlera e tyre edhe niveli i punësimit.

3. Treguesit aktuale të industrisë Jo Ushqimore (Të dhënat sipas INSTAT, periudha 2010-2015)

3.1. Ecuria e industrisë përpunuese

Peshën e industrisë përpunuese të mineraleve metalore e kanë mbajtur kromi dhe bakri, dhe industria e përpunimit të mineraleve të hekurit, duke zgjidhur disa nevoja të ekonomisë, por edhe si kontributorë në eksport. Industria e përpunimit të mineraleve jo metalore për prodhim çimento, tulla, tjegulla, gëlqere etj. ishte e destinuar për të përballuar nevojat e vendit me material ndërtimi, si dhe disa sektorë të tjerë, me prodhime qeramike e industrinë e qelqit.

Deri në vitin 2000, administrimi i shumë prej këtyre ndërmarrjeve industriale ishte shtetëror, pa ndonjë model apo strategji konkrete, për një sinkronizim të kërkim-zbulimit, nxjerrjes nga nëntoka, deri në përpunimin e këtyre pasurive me efektivitet. Industria e prodhimit të çelikut në Elbasan thuajse nuk arriti të funksionojë që në fillim të viteve të para të tranzicionit, duke mbetur vetëm sektori i prodhimit të çelikut në kapacitete minimale me përpunim mbetjesh metalike.

Referuar të dhënave të **Import-Eksport** sipas grup-mallrave vihet re deficit tregtar në tërësi por edhe sipas degëve, duke patur bilanc me negativ, në sektorët e kimisë, industrinë mekanike, prodhime prej lëkure madje edhe në metale dhe materiale ndërtimi. Sa i takon eksportit të mineraleve, për rastin e daljes në eksport me koncentrate bakri si dhe të mbetjeve të bakrit e lidhjeve të tij, ka vend rivlerësimi tekniko-ekonomik për mundësi thellim përpunimi në vend i tyre për rritjen e vlerës së shtuar e kontributit në eksport.

Peshën kryesore në eksportin brënda fushës së industrisë e zë Tekstil-Konfeksionet dhe Lëkurë Këpuca rreth 50 % si dhe Metalurgji-Riciklimi rreth 26 %. Nga të dhënat për eksportet me vendet e rajonit e ato fqinjë, rezulton se vendin kryesor e zë Italia me rreth 50 – 51 % të vlerës se eksporteve. Vihet re mungesa e eksporteve me Kosovën apo ndonjë vend tjetër fqinjë, ndërsa produktet e industrisë të lekurë – këpucëve si rrjedhojë e investimit e organizimit të veprimtarisë tip përpunimit aktiv, eksporti kryhet thuajse totalisht me Italinë.

Nga të dhënat krahasimorë Janar-Maj 2014 me Janar-Maj 2015, kemi rritje eksporti me Kosovën nga 6 në 11 %, referuar disa reformave bashkëpunuese midis dy vendeve pas vitit 2013.

Industria e drurit dhe letrës eksporton produktet në Itali, Greqi, ndërsa për produkte kimike marrëdhëniet janë më tepër me Greqinë me rreth 32 % eksport, pasuar me Bullgarinë, Malin e Zi dhe Turqinë. Industria e gomë – plastikës është e orientuar në marrëdhëniet e tregtimit me Italinë rreth 56 %, dhe Greqinë rreth 37 %. Sa i takon industrisë se prodhimit të materialeve të ndërtimit, bie në sy një eksport me Malin e Zi, pastaj me Italinë, Kosovën, Serbinë dhe Greqinë.

Metalurgjia dhe riciklimi i metaleve, peshën kryesore në eksport e zëne Italia, Turqia, pastaj Greqia dhe Bullgaria së bashku me Malin e Zi. Sektori i prodhimeve të industrisë mekanike kryen veprimtarinë të orientuar në eksport me Italinë rreth 50 % të vlerës se mallit, pasuar me Greqinë rreth 40 %, e me radhe Turqi, Serbi etj. (Te Shtojca jepen tabela me të dhëna për kontributin në tërësi të industrisë jo ushqimorë dhe sipas degëve të saj si dhe marrëdhëniet me rajonin etj.)

Te dhëna për bilancin e vendit import-eksport ne total te mallrave e produkteve

Nr	Viti	Eksport (mln. Lekë)	Import (mln. Lekë)
1	2009	104.515	428.839
2	2010	161.548	477.768
3	2011	196.897	544.004
5	2012	213.029	528.491
5	2013	246.391	517.378
6	2014	255.759	552.279
7	2015	243.181	544.559

Burimi: INSTAT

Bilanci import – eksport vjen duke u zbutur nga raport rreth 1 me 4 ne 1 me 2 qe tregon për një ecuri graduale e zhvillimit te industrisë duke kontribuar në eksportin vendas. Vlen të theksohet se në eksport industria jo ushqimorë kontribuon nga rreth 48 % deri 62 % (v.2015), të eksportit total në shkallë vendi, e ku peshën kryesore e zë tekstil-konfeksione dhe lëkure këpuca.

Nga të dhënat e vitit 2014 eksporti me vendet e Ballkanit përfundimor arrin vlerën e rreth 11 %, viti 2015 në 12,4 % ndërsa importi rreth 6 – 7 %. Ritmi mesatar i rritjes së eksporteve sidomos pas vitit 2010 ka qenë në nivelet e 9 – 12 %, ndërsa i importeve nga 5 deri 14 %.

Të dhëna për qarkullimin vjetor në eksport sipas degëve të industrisë

milion leke

Nr	Emertimi i Veprimtarise	2010		2011		2012		2013		2014		2015	
		Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
1	Tekstil konfeksione	11.6	9.39	12.3	9.09	13.7	9.09	36.03	26.08	32.07	21.7	33.48	22.12
2	Lekure Kepuca	15	12.15	17.1	12.64	14.7	9.75	35.49	25,69	56.942	38.5	59.508	39,32
3	Prodhim material Ndertimi	33.9	27.45	35.9	26.53	34.9	23.16	9.087	6.58	8.533	5.77	8.100	5,4
4	Druri dhe letra	11.1	8.99	11.9	8.80	12.3	8.16	10.24	7.42	9.181	6.2	8.336	5.5
5	Riciklimi	2.8	2.27	5.1	3.77	5.4	3.58	5.800	4.2	4.8	3.24	5.2	3.4
6	Goma plastika	8.4	6.80	8.5	6.28	16.9	11.21	2.173	1.57	1.694	1.15	2.161	1.43
7	Industria kimike	0	0.00		0.00		0.00	2.006	1.45	1.70	1.15	1.8	1.2
8	Industria mekanike	15.8	12.79	18.1	13.38	21.4	14.20	6.673	4.83	9.235	6.24	10.789	7.13
9	Metalurgjia	24.9	20.16	26.4	19.51	31.4	20.84	30.65	22.18	23.77	16,25	21.98	14.5
	Shuma	123.5	100.00	135.3	100.00	150.7	100.00	138,156	100.00	147.925	100.00	151.354	100.00

Burimi: INSTAT

Nga kjo tabelë rezulton se pjesa e mallrave që sigurohen prej veprimtarive të industrisë përpunuese (jo ushqimore), per vitin 2013 arrin një kontribut prej 138.156 milionion leke ose rreth 53,84 % ndaj totalit të industrisë, e ketu tekstil këpuca zë rreth 28 % ndaj totalit të

ekonomisë. Ndërsa në vitet 2014 dhe 2015 ind. Jo ushqimore ka rritje 7 – 9 % në krahasim me vitin 2013, e përsëri peshën kryesore e mban Industria e Tekstil-Këpucëve.

Struktura e eksport - importit për mallrat me BE-në, Ballkanin Perëndimor e vende të tjera viti 2014 dhe 2015 *mln. Leke*

Vendi	Eksporti 2014	Ne %	Importi 2014	Ne %	Eksporti 2015	Ne %	Importi 2015	Ne %
Me vendet e BE	197.061	77.0 %	337.437	61%	186.750	76.8%	374.054	68.7%
Ballkani perëndimor	27.261	10,7%	37.766	7%	32.345	13.3%	48.987	9%
Vende të tjera	31.437	12,3%	177.076	32.0%	24.088	9.9%	121.519	22.3%
Totali	255.759	100	552.279	100.0	243.183	100.0	544.560	100

Burimi: INSTAT

Eksporti me vendet e Ballkanit perëndimor për vitin 2015 është 32.345 milion, ku me Kosovën është 21.000 milion lekë duke treguar qarkullimin e mallrave shqiptare drejt saj. Ndërsa importi me vendet e Ballkanit perëndimor është 48.987 milion lekë, nga ku Kosova zë rreth 5.500 milion lekë (11,2 %), që tregon rritje volumi.

Në total industria Jo Ushqimore në vitin 2014 arriti eksport rreth 1.2 miliard \$ nga 2.1 miliard \$ total në shkallë vendi (apo rreth 56,47 % të totalit).

Nga kjo tabelë, bie në sy rritje e tregtisë me vendet e BE-së, por akoma në nivele të ulëta me vendet e Ballkanit perëndimor.

Te dhëna për eksportin sipas vendeve të Ballkanit perëndimor për vitin 2015 *milion leke*

Emertimi mallrave	Maqedonia	Mali Zi	Serbia	Bosnje-Hercegovina	Kosova	Kroaci	Slloveni
Ushqim, pije duhan	776.508,57	566.976,99	1.194,577,420	367,302,952	2.300,840,458	297,637,135	17,617,301
Minerale, lëndë djegëse, elektro - energji	2.014,141,429	1.446,856,223	1.408,657,748	13,968,591	8.557,990,391	363,813	1.107,356,315
Industria Joushqimore							
Produkte kimike dhe plastike	159,699,689	204,958,585	41,075,832	53,969,589	1.130,460,164	2,411,794	2,861,404
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	3,996,377	0	132,894	151,705,273	1,655,205	0	0
Prodhime druri dhe letre	184,390,195	49,064,615	72,222,528	1,371,413	317,175,165	7,246,108	1,466,471
Tekstile dhe këpucë	102,807,313	15,431,415	228,707,072	15,863,516	81,137,613	78,891,683	0
Materiale ndërtimi dhe metale	1.924,183,275	947,586,057	132,836,524	10,211,271	6,834,005,410	82,193,810	11,334,979
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	953,301,941	62,536,764	11,903,541	9,082,323	564,991,737	17,766,828	6,046,388
Totali Ind. Jo Ushqimore	6.119,028.633	3.293,410.653	414,855.863	242,203.385	8.929,425.294	188,510.223	21,709.242
Të tjera	294,807,402	81,537,137	114,331,919	24,132,801	1,132,562,144	1,074,948	81,648
Gjithsej	6.413,836.035	3.374,947.790	3.132,422.950	647,607.729	20.918,817.287	487,586.119	1.146,764.506

Nga të dhënat e tabelës, duket qartë tendenca e rritjes së eksportit me Kosovën, por edhe me vende të tjera të rajonit si Maqedonia, dhe Mali I Zi, e natyrisht kërkohet rritje e vlerave në të ardhmen.

Totali i produkteve të eksportuara me keto vende është rreth 33.000 milion lekë, ndërsa produkte të industrisë Jo Ushqimore janë rreth 19.206 milion lekë ose rreth 58 % zë kjo industri.

Me Kosovën ky eksport arrin në rreth 46,5 % të vlerës së produkteve të industrisë Jo Ushqimore. Vlera e eksporteve të produkteve të industrisë Jo Ushqimore me këto vende zë rreth 15 % të vlerës totale të mallrave të eksportit në shkallë vendi për vitin 2015.

4. Institucionet dhe organizatat që lidhen me industrinë Jo Ushqimore

Në fushën e veprimtarisë së industrisë Jo Ushqimore veprojnë dhe kanë fushë të përbashkët me MEI një serë institucionesh dhe organizatash, të cilat kanë rol direkt dhe indirekt në zhvillimin e saj në harmoni të plotë me kuadrin ligjor e rregullator, si dhe kërkesat për zhvillim të qëndrueshëm, me produkte cilësore dhe të sigurt, konkurrueshmëri dhe sofistikim të produkteve shqiptare.

Më poshtë janë renditur institucionet dhe organizatat:

- Organet politikberese në nivel qendror

- Organet e pushtetit vendor, që kanë rol kryesor në mbështetjen e veprimtarisë së tyre, duke planifikuar në projektet zhvillimore rajonale në përputhje me asetet dhe burimet natyrore poseduese si pjesë e integruar e planifikimit të territorit.

- Organe doganore dhe tatimore

- Qendra Kombëtare e Biznesit (bashkimi i QKR me QKL)

- Organet e tjera rregullatore si Agjensi të nivelit kombëtar, (Agjencia e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Trajtimit të Pronave, ZRPP, etj.

- INSTAT

- Institucione arsimore, shkolla profesionale, qendra e formimit profesional, si dhe Universitet që sigurojnë kontigjente specialistesh të lartë në fushën e sektorëve të kësaj industrie.

- Institucione studimore e shkencore
- Inspektorati i fushes se industrise Jo Ushqimore (ISHTI) dhe Inspektorate të Punës apo Shëndetit Publik
- Organizata të ndryshme : Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Konfindustria,
- Shoqata të ndryshme të organizuara sipas fushave të kesaj industrie: Shoqata e industrisë përpunimit aktiv, Shoqata e Përpunim – Drurit etj.
- Institucionet bankare
- Subjekte private që operojne në fushen e studimeve dhe projekteve
- Institucione rregullatore: Autoriteti i Konkurences, EITI, Task forca dhe Institucionet e pastrimit të parave
- Përfaqesitë diplomatike që shërbejne në vende të ndryshme si promovuese suplementare të ekonomise shqiptare si dhe nevojat për mundesi thithje investimi apo për eksporte produktesh
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

5. Kuadri ligjor

Në lidhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe industrisë Jo Ushqimore si pjesë integrale e saj në vite eshte krijuar një legjislacion që rregullon marrëdhëniet e biznesit me shtetin për të siguruar kushte sa më optimale në lidhje me investimet në veprimtari të ndryshme sipas politikave orientuese zhvillimore, si dhe kryesisht të përputhjes së interesave të vetë investitorit me ato të vendit.

Ky legjislacion është përafëruar pjesa më e madhe me atë të BE-se si dhe përmirësohet rast pas rasti në vartësi të problematikës gjithnjë në funksion të një harmonizimi sa më të mirë midis interesave të biznesit me ato të zhvillimit ekonomik të vendit.

Në këtë drejtim janë ndërmarrë disa reforma rregulatore për transformimin e ekonomisë së trashëguar në kushtet e ekonomisë së tregut, nepermjet formave të ndryshme të privatizimit etj.

Pjesa kryesore e sektorëve të kesaj industrie është e privatizuar, dhe pak asete të mbetura akoma janë në proces transferimi për administrim privat.

PJESA II

KUADRI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E INDUSTRIË JOUSHQIMORE

Ecuria e deritanishme, përballë një ekonomie globale, kërkon mirë organizim e programim, për të zhvilluar ato degë të industrisë që janë konkurruese në treg, sigurojnë të ardhura maksimale e kontribuojnë në nivelin e punësimit e mirëqenies në vendin tonë. Zhvillimi kaotik për periudhën 25 vjeçare, përballë rritjes së konkurrencës në treg, referuar disa avantazheve si pozicioni gjeostrategjik, burimet natyrore etj. duhet shoqëruar me rritje të nivelit të bashkëpunimit mbi bazë degësh të industrisë duke krijuar bashkime të subjekteve në njësi më të mëdha, madje edhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë e interesa që rrisin performancën e ulin koston e prodhimit.

Një model i tillë që shumë vende e kanë aplikuar janë edhe bashkime mbi bazë interesash jo vetëm i subjekteve por edhe me qarqe akademike, OJF etj. Është jo optimale që kontributi i industrisë jo ushqimore në PBB-në e vendit varioj 4 – 4,5 %, kur vendet e rajonit e kanë 8 – 15 %. Kjo kërkon rivlerësim e bashkërendim më të mirë midis shtetit e biznesit me politika makro por edhe nivele sektori, mbështetje e atyre sektorëve që rrisin të ardhurat nëpërmjet një shfrytëzimi sa më efikas të aseteve e burimeve natyrore.

6. Vizioni, qëllimet dhe objektivat strategjike për industrinë

Vizioni Klimë më miqësore dhe informuese për biznesin, në funksion të rritjes së interesit të investitorëve strategjik e seriozë për zhvillimin e industrisë jo Ushqimore, me raporte interesash reciproke por gjithnjë sa më të balancuara, për nxitjen e zhvillimin e degëve që sigurojnë shfrytëzimin më racional të potencialeve natyrore e njerëzore, konkurruese në treg, sigurojnë të ardhura maksimale në dobi të vendit, nëpërmjet një politike mbështetëse, lehtësuese, monitoruese, për veprimtari prodhuese të sigurtë për shëndetin e mjedisin, në përshtatje me eksperiencat bashkëkohore, e legjislacionin e BE-se, sipas një strategjie të mirë harmonizuar me të gjithë aktorët e faktorët ndikues në arritjen e këtij qëllimi.

Vlerat ku mbështetemi Bazuar mbi traditën e zhvillimit të industrisë jo Ushqimore, duke u krahasuar me tregun rajonal e global, me një politike mbështetëse të zhvillojmë rrugët efektive, për veprimtari prodhuese të sigurtë për shëndetin e mjedisin, në përshtatje me eksperiencat e

mira ndërkombëtare, në përfaqësim me legjislacionin e BE-së, një strategji e mirë harmonizuar me të gjithë faktorët ndikues në arritjen e objektivave strategjike.

Fokusimi i dokumentit strategjik

Zhvillimi i industrisë do të fokusohet në eksperiencën e deritanishme, për t'i orientuar më mirë në lidhje me shpërndarjen rajonale, përmirësim në nivelin e teknologjisë, uljen e kostos, mirë përdorimin e burimeve natyrore e asete të tjera, në funksion të sigurimit të një produkti cilësor, konkurrues, me rritje të kontributit në PBB dhe punësim. Degët kryesore të industrisë mendojmë se do të jenë ajo e përpunimit me cikël sa më të plotë të burimeve natyrore si minerale metalore dhe jo metalore, industria e drurit, lëkurë - këpuca, riciklimi, gomë-plastika, industria mekanike dhe ajo përpunimit aktiv (përpunimit aktiv) me tekstil-konfeksionet.

6.1. Qëllimet për zbatimin e strategjisë

Nëpërmjet analizes së gjëndjes aktuale të industrisë jo ushqimore në vendin tonë, të ecurisë së saj, efektivitetit në ekonomi, të arrihet tek mënyrat që duhet të orientohet kjo degë e ekonomisë së vendit, duke përcaktuar prioritetet, objektivat dhe disa politika që mundësojnë zhvillim harmonik e të qëndrueshëm.

6.2. Objektivat kryesore që synohen të arrihen

Me miratimin e dokumentit synojmë që :

- Nepermjet krijimit të një baze të dhënash informatike dhe përditësimit periodik, sipas fushës së veprimtarive për subjektet e licencuara që operojnë në fushën e industrisë jo ushqimore, do të krijohet një instrument informues për të rritur shkallën e bashkëpunimit me biznesin që ushtron veprimtari në këtë industri.
- Synojmë që nëpërmjet një administrimi më efikas të ish objekteve industriale, dhe një rehabilitimi pjesor të tyre, të realizojmë brënda vitit 2018 transferimin tek administrimi privat i aseteve të mbetura, duke siguruar maksimizim të vlerës së mbetur e orientuar

përdorimin e tyre për destinacione veprimtari prodhuese industriale apo shërbime të tjera me interes ekonomik.

- Përgatitim infrastruktura e duhur me sigurim ekspertize sipas modeleve të vendeve të rajonit, dhe në bashkërendim me institucione të tjera të punohet për krijimin e një grupimi në një prej degëve të fushës së industrisë. Paralelisht do të përmirësohet kuadri ligjor rregullator në shërbim të këtij organizimi të bizneseve të vogla në njësi më të mëdha.
- Nxitim e mbështetim rritjen e shkallës së përpunimit të disa burimeve potenciale natyrore si kromi, bakri, kuarcitet, nikel-silikatet apo edhe aseteve të tjera si lëkura (për përpunim), së bashku edhe me riciklimin e mbetjeve, e sidomos të atyre metalike, për të realizuar përpunimin e plotë deri në produkt final.
- Rritim peshën e industrisë jo ushqimore në PBB-së në rreth 6 -7 % brënda vitit 2020, nga 4 – 4, 5 % në vitin 2015.
- Përmirësojmë monitorimin e veprimtarive industriale (objekte të dhëna me koncesion apo qira simbolike 1 euro etj), sidomos të atyre që përpunojnë burime natyrore, për të siguruar parametra teknike e teknologjike bashkëkohor si dhe shmangur evazionin në lidhje me mirëadministrimin e aseteve të dhëna për shfrytëzim.
- Bashkërendim me strukturat ligjore, shoqërinë civile si pjesë e rëndësishme në dhënien e mendimeve oponentë, me synim nxitje e mbështetje për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në sektorin prodhues, forcimi i bashkëpunimit midis ndërmarrjeve dhe institucioneve të arsimit të lartë publik me synim rritjen e numrit të projekteve të përbashkët ndërmjet sektorit publik të arsimit të lartë dhe sektorit privat. Tërheqje mendimi oponent prej këtyre strukturave për studime e projekte specifike, përpara etapave të tjera për miratim.
- Përmirësimi i rolit rregullator të institucioneve përgjegjëse për industrinë, dhe nivel më i lartë bashkërendimi me strukturat e tjera politikbërëse në fushën e mjedisit etj, për të orientuar më mirë politikat zhvillimore që lidhen me industrinë jo ushqimore, të cilat sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm e miqësor me mjedisin.

Masat kryesore për arritjen e objektivave do të përfshijnë:

- Bashkërendimin
 - me subjektet prodhuese në fushën e industrisë jo ushqimore, për të nxitur investime në zbatimin e teknikave më të mira të aplikueshme që shoqërohen me uljen e ndikimit në shëndet dhe mjedis, kursimin e burimeve energjetike dhe lëndës djegëse etj.
 - e programeve të përbashketa me Agjencinë Zhvillimit të Investimeve (AIDA) me synim nxitjen e projekteve me interes në fushën e industrisë jo ushqimore dhe rritjen e nivelit të investimeve;
 - me QKB (ish QKR, QKL), Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, INSTAT me synim lehtësimin e sigurimit të monitorimit dhe informacionit pjesë e hartimit të politikave sektoriale;
 - me institucionin politikbërës të mjedisit dhe ruajtjes së shëndetit, me synimin për ulje të shkarkimeve në ajër nga instalimet e veprimtarisë industriale
- Evidentimin e kimikateve, të pa sistemuara akoma në ish objektet industriale, (si helme me efekt të fortë e kimikate të rrezikshme), të cilat kanë humbur qëllimin funksional të projektuar vite më parë.
- Komunikimin me institucionin për mbrojtjen mjedisore dhe planifikimit të territorit, nevoja për të përgatitur infrastrukturën *për landfill* rajonale që shërbejnë për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme të krijuara nga aktivitete prodhuese etj. të cilat nuk mund të ripërdoren, riciklohen apo transferohen jashtë vendit.
- Konsultimin me shoqërinë civile, si pjesë e rëndësishme në dhënien e mendimeve oponentë, me synim nxitje e mbështetje për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në sektorin prodhues, forcimi i bashkëpunimit midis ndërmarrjeve dhe institucioneve të arsimit të lartë publik me synim rritjen e numrit të projekteve të përbashkët ndërmjet sektorit publik të arsimit të lartë dhe sektorit privat. Tërheqje mendimi oponent prej këtyre strukturave për studime e projekte specifike, përpara etapave të tjera për miratim.
- Realizimin e vlerësimeve tekniko-ekonomike për industrinë e lëkurë – këpucëve, bakrit, Kuarciteve, Nikel-Silikateve e industrive të tjera, për promovimin tyre, me synimin për realizimin e ciklit të përpunimit në vend, nga lënda e parë deri në produkt final, në bashkërendim me qarqe akademike, institucione studimore publike dhe private.
- Nxitje dhe stimulim i sektorit të pasurimit dhe shkrirjes në industrinë e kromit si vlerë e shtuar për rritjen e shkallës së përpunimit në vend me impakt në punësim, eksport etj.

- Nxitjen e interesit të investitorëve në ish territore industriale nëpërmjet një rehabilitimi pjesor të tyre duke i kthyer në miniparqe industriale si atraktive për zhvillim, e realizuar procesin e transferimit të plotë të tyre nga administrim shtet në privat (viti 2018)
- Marrje ekspertize të huaj dhe krijim infrastrukure të përshtatshme për mundësinë e krijimit të një Cluster-i në një prej degëve të industrisë (ind. perp.drurit etj)
- Monitorimin e disa koncesnioneve të dhëna, sidoemos në industrinë përpunuese të bakrit etj, rivlerësim i ecurisë së tyre, në lidhje me zbatimin e kushteve e detyrimeve sipas marreveshjeve e kontratave respektive deri në zgjidhjen e plotë, dhe promovim për të mundësuar investitorë serioz dhe strategjik
- Rritjen e nivelit të bashkëpunimit me vendet e rajonit, me takime, seminare, për shkëmbim eksperience dhe bashkepunim për një treg më të gjërë përballë konkurrencës në rritje.

6.2.1 Objektivat ekonomike

Objektivat ekonomike per periudhen qe mbulon dokumenti strategjik do te synojne qe :

- kontributi i industrisë jo ushqimore në PPB-së të rritet nga 4 – 4,5 % tani, në rreth 6 - 7 % brënda vitit 2020 dhe niveli rreth 8 -9 % viti 2025.
- niveli i punësimit ne sektorët e industrisë jo ushqimore, të rritet 2 deri 2.5 % ne vit.
- kontributi në eksport, të rritet ne masën 1.5 – 2 % ne vit.
- Të kontribuohet në arritjen e objektivit për zbutjen e deficitit tregtar (import – eksport), nga një tregues prej – 24 % ndaj GDP-së, viti 2010, në – 14 % viti 2020, (për ekonominë në shkallë vendi), kjo referuar dokumentit për ecurinë e zhvillimit ekonomik për vendet e Europës Juglindore deri 2020. Si rrjedhojë ky tregues i industrisë jo ushqimore (si pjesë e integruar në ekonominë e vendit), nga -18,7 % (viti 2010, deficitit tregtar ndaj GDP-së, synohet të arrijë në rreth – 14 % (viti 2020).

6.2.2. Objektivat zhvillimore

Nivel ekonomie

1. Mbështetje dhe promovim i projekteve dhe aktiviteteve industriale që gjenerojnë të ardhura dhe punësim.

2. Nxitje, mbështetje dhe promovim i biznesit drejt rajonit të burimeve natyrore e potencialeve njerëzore, me synim evitim të disballancimit të zhvillimit industrial rajonal, si instrument për uljen e papunësisë por edhe maksimizim vlerash të këtyre aseteve.

3. Përmirësim i klimës për tërheqjen e investimeve të huaja si një instrument potencial në zhvillimin e industrisë

4-Promovim e nxitje e aplikimit të teknologjive bashkëkohore (BAT, best available techniques) sipas degëve të industrisë, me synim ulje kostoje, ulje kosnum energjie elektrike dhe rritje sigurie në shëndet dhe mjedis.

-5-Mbështetje e investimeve që sigurojnë rritje të shkallës së përpunimit në vend të **burimeve natyrore** e aseteve të tjera, si instrument bazë në rritjen e të ardhurave, eksportit, PBB-së e punësimit.

Nivel sektori

1. Promovimi për një mire organizim nga mikro aktivitete në njësi të mëdha, duke shfrytëzuar më mirë kapacitetet aktuale industriale, së bashku me grupim interesash me qarqet akademike, OJF etj, modeli i përqendrimeve rajonale në nivele dege industrie.

2. Krijim kushtesh për vlerësim e monitorim të aktiviteteve industriale me synim zhvillimin e qëndrueshëm.

3. Përmirësim i infrastrukturës për zhvillimin e industrisë, që nga ajo inxhinierike e territoriale, por sidomos e aseteve njerëzore në shërbim të hartimit të politikave, vlerësimeve tekniko-ekonomike sipas prioriteteve dhe interesave të vendit.

4. Nxitje e politikave për riciklimin e mbetjeve metalike e të tjera, me synim arritjen e përpunimit deri në produkte finale me destinacion tregun vendas dhe eksport.

5. Nxitje e politikave për mirë përdorimin e të ardhurave që krijohen nga privatizimi i disa aseteve (demolim makineri-pajisje të mbetura) në shërbim të mbështetjes së shtimit të resurseve, për investim në ciklin e përpunimit, apo ish objekte industriale, me synim rritjen e vlerës së shtuar të pasurive natyrore e aseteve publike.

6. Rivlerësim për mundësi aktivizimi me cikël të plotë i disa prej industrive tradicionale që mbështeten me burime natyrore, si bakri, kromi, kuarcitet, nikel-silikatet e ferro-nikeli, lëkurë – këpuca etj.

7. Përmirësim i kushteve juridiko-organizative, mbështetje me kapacitete profesionale, për një vlerësim oponent më të specializuar të projekteve industriale që nga faza e projekt-idesë deri në dhënien e lejes së përdorimit, si instrumenta rregullatore në zhvillimin harmonik të industrisë dhe ruajtjes së territorit
8. Rritje e nivelit të bashkëpunimit midis institucioneve politikëbërëse, dhe biznesit me aktorë të tjerë si arsimi i mesëm e ai universitar për programime më të mira në lidhje me kryerje studimesh vlerësuese tekniko-ekonomike në fushën e industrisë jo ushqimore, oponenca, tërheqje mendimi me anketime e konsulenca në shërbim të politikave zhvillimore dhe përgatitjet e profesionistëve të ardhshëm me synim thithjen e kontingjenteve përkatëse.
9. Të punohet për uljen e shkarkimit në ajër të ndotësve potencial pluhura e gaze, nëpërmjet zbatimit të teknikave bashkëkohore e zbatimit korrekt të kuadrit ligjor për mjedisin dhe shëndetin.
10. Përmirësim të mënyrës së komunikimit me subjektet që operojnë në fushën e industrisë, duke aplikuar metoda anketimi së paku një herë në dy vite, krijim kushtesh për kontakte direkte, për të siguruar mendime e sugjerime në funksion të harmonizimit më mirë të ideve, projekteve dhe zbatimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike.
11. Të rehabilitohen dhe promovohen për zhvillim veprimtarie industriale disa territore në ish objekte industriale të cilat kanë humbur destinacionin e tyre historik prodhues, si Elbasan, Fier, Laç, Rubik, Shkodër, Burrel me synim thithjen e investitorëve vendas e të huaj, në kuadrin e miniparqeve industriale, sepse disponojnë një infrastrukturë pjesore inxhinierike, si rruge, sheshe, rrjetin e ujëra-kanalizimeve, furnizimin me energji etj.
12. Evidentim i kimikateve, të pa sistemuara akoma në ish objektet industriale, (si helme me efekt te fortë e kimikate të rrezikshme) të cilat kanë humbur qëllimin funksional të projektuar vite më parë, sigurim burimesh njerëzore e financiare, për administrim ligjor të tyre
13. Përgatitja e fish-projekteve dhe kërkimi i donatoreve të huaj për mundësi asgjësimi të substancave dhe preparateve të rrezikshme të depozituara në depon përkatëse në Elbasan, si dhe ndjekie ecurisë së këtij procesi, nga institucione të specializuara.
14. Të sugjerohet institucionit për mbrojtjen mjedisore dhe planifikimit të territorit, nevoja për të përgatitur infrastrukturën **për landfille** rajonale që shërbejnë për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme të krijuara nga aktivitete prodhuese etj. të cilat nuk mund të ripërdoren, riciklohen apo transferohen jashtë vendit.

15. Harmonizimi i kompetencave dhe përgjegjësi të inspektoratit dhe strukturës administrative përgjegjëse në vartësi të saj si edhe bashkëpunimi i tyre me institucionet e tjera përgjegjëse të sistemit kombëtar të inspektimit dhe mbikqyrjes së sigurisë teknike të produkteve/pajisjeve/instalimeve;
16. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore të inspektoratit dhe strukturës administrative përgjegjëse në vartësi të MEI-t, plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për inspektimin dhe mbikqyrjen e tregut dhe rregullat për sigurinë teknike të produkteve/pajisjeve/instalimeve, i orientuar drejt përafrimit të plotë me legjislacionin e BE-së.
17. Bashkërendim me Agjencinë promovuese të investimeve (AIDA) me synim nxitjen e projekteve me interes në fushën e industrisë jo ushqimore dhe rritjen e nivelit të investimeve.
18. Bashkërendim me QKB (ish QKR, QKL), Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, INSTAT etj. me synim lehtësimin e sigurimit të monitorimit dhe informacionit pjesë e hartimit të politikave sektoriale.
19. Rritje e nivelit të bashkëpunimit me vendet e rajonit, me takime, workshop-e, për shkëmbim eksperience dhe kooperim për një treg më të gjërë përballë konkurrencës në rritje.
20. Në bashkërendim e mbështetje të institucionit politikbërës të mjedisit dhe ruajtjes së shëndetit, të synohet ulja e shkarkimeve në ajër nga instalimet e veprimtarisë industriale.
21. Bashkërendim me institucionet, shoqërinë civile si pjesë e rëndësishme në dhënien e mendimeve oponentë, me synim nxitje e mbështetje për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në sektorin prodhues, forcimi i bashkëpunimit midis ndërmarrjeve me aftësi teknologjike dhe institucioneve të arsimit të lartë publik me synim rritjen e numrit të projekteve të përbashkët ndërmjet sektorit publik të arsimit të lartë dhe sektorit privat. Tërheqje mendimi oponent e këtyre strukturave për studime e projekte specifike, përpara etapave të tjera për miratim.

6.3. Analizë e prioritetëve zhvillimore për secilën degë të industrisë

Industria e përpunimit të mineraleve metalore.

Metalurgjia

Bakri

Nisur nga fakti se ekzistojnë asete pjesërisht të ruajtura në industrinë përpunuese të bakrit si Uzina e Telave dhe Kabllave në Shkodër, dhe Uzina e Rafinimit të Bakrit në Rubik, me rezerva minerare optimale krahasuar me statistikën botërore për frymë popullsie, e burime të tjera dytësore skrapë metalike, në kushtet e rritjes të kërkesës në treg për metal bakri, paraqet interes, një vlerësim tërësor tekniko-ekonomik, për të gjykuar efektivitetin e skemës së administrimit të këtyre pasurive, nëse është me leverdi përpunimi deri në gjysmë produkt koncentrate bakri dhe eksport, apo përpunimi në vend deri në produkte finale.

Për këtë qëllim MEI ka iniciuar një studim parafizibiliteti për industrinë e bakrit, nëpërmjet strukturave të vartësisë, e pas vlerësimeve opionetë prej qarqeve akademike dhe ekspertëve të fushës, tashmë do t'përdorë si një instrument që mundëson rivlerësimin e aseteve dhe burimeve në dispozicion për rritje të vlerës së shtuar nëpërmjet thithjes së investitorëve serioz për ciklin e plotë të saj. Nëse gjatë promovimit sigurohen investitorë për administrimin e vendburimeve të reja minerare dhe dy objekteve Uzinat e Bakrit në Rubik dhe Telave e Kabllave në Shkodër, krijohen mundësi rritje vlerë e shtuar në eksport, buxhet dhe punësim së paku 1 mijë veta.

Alumini dhe Plumbi

Industria e përpunimit dhe prodhimit të aluminit nga lënda e parë minerare shoqërohet një skemë të gjatë teknologjike dhe ndër të tjera ka konsum të lartë energjie elektrike. Megjithatë nuk përjashtohet varianti i rivlerësimit tekniko-ekonomik e disa vendburimeve natyrore në formë boksitesh, për mundësi përpunimi deri në gjysmë produkt okside alumini, si një mall i kërkuar në treg.

Në vazhdimësi prodhimi me anë të riciklimit të mbetjeve metalike me bazë aluminin, mbetet objektiv e duhet mbështetur sepse kemi përfitim metalik me kosto më të ulët, krahas uljes së impaktit në mjedis. Ndërsa industria e prodhimit të plumbit mbetet ajo e konsoliduar tashmë me riciklimin e elementeve prej plumbi nga bateritë apo skrapë të tjera metalike prej plumbi.

Kuarcitet dhe rërat kuarcore

Vendi disponon rezerva minerale kuarcore, të shpërndara në disa rajone, Tropoje, Kukës, Shkodër, Korçë, Pogradec, dhe Tiranë, madje kemi rezerva të pasura nga 90 deri 95 % SiO₂ përmbajtje, të cilat këto vite nuk kanë ndonjë kontribut të ndjeshëm në ekonominë e vendit.

Në shumë sektorë të ekonomisë ka kërkesa tregu për këtë lëndë të parë e cila duhet përpunuar për rritjen e cilësisë në përmbajtjen e SiO₂, sepse përdoret për fonderitë, industri qelqi etj. Në mënyrë që të rriten vlerat e kësaj pasurie, është me interes një studim-tekniko-ekonomik duke marrë në analize mundësitë tona nëpërmjet përpunimit në vend, me anë të pasurimit etj. përballe një tregu rajonal e konkurrues.

Nikel-silikate

Vendi ynë disponon rezerva nikel-silikati sidomos në rajonin jug-lindor të Korçës, të cilat deri tani nuk kanë ndonjë ecuri me kontribut të ndjeshëm në bilancin ekonomik, krahasuar me mundësitë për një rritje shkalle përpunimi. Meqenëse niveli i të ardhurave që sigurohet prej kësaj pasurie rezulton akoma i ulët, është me interes një rivlerësim me studim tekniko-ekonomik, ku të analizohen variantet e mundëshme për përpunim në vend me synim rritjen e vlerës së përdorimit të tyre.

Për te dy këto burime minerare, MEI ka filluar procedurat e hartimit të detyrave të studimit duke bashkërenduar edhe me qarqet akademike dhe AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), për të siguruar realizimin e tyre, të cilat shërbejnë për orientim të institucioneve politikbërëse në fushën e industrisë përpunuese, si mundësi rritje interesi për investitorë serioz e strategjik .

Hekur-Nikeli

Sa i takon kësaj pasurie referuar rezervave që disponon vendi dhe nevojave të tregut rajonal e me gjërë, mendojmë se kërkohet vlerësim për rritje shkalle përpunimi nëpërmjet pasurimit duke krijuar kushte për vlerë të shtuar, e kontribut në eksport dhe punësim në rajonet poseduese.

Prodhim çeliku dhe gize

Kjo industri siç është trajtuar deri tani këto 15 vite ka rezultuar e konsoliduar bazuar mbi lëndën e parë mbetje hekuri që sigurohen pjesërisht nga vendi por shumica nga importi. Edhe në të ardhmen parashikohen këto ritme prodhimi, por është me interes përmirësimi i strukturës së

prodhimit me profile prej çeliku apo asortimente të tjera të mundëshme referuar strukturës së nevojave të vendit, të cilat deri tani importohen. Në këtë sektor është domosdoshmëri aplikimi i teknikave të avancuara (BAT) që sigurojnë jo vetëm kursim energjie elektrike dhe lëndë djegëse por edhe ulje impakti në mjedis.

Sa i takon produkteve prej gize, është e nevojshme që të promovohet e nxitet interesi për investime pasi kërkesat për këto produkte janë të larta, sidomos në sistemin e ujëra-kanalizimeve në gjithë rrjetin inxhinierik të subjekteve prodhuese, zonave urbane, etj.

Përpunimi i Kromit

Përveç dy uzinave të prodhimit të ferro kromit në Elbasan e Burrel, ka kërkesa për uzina të reja, dhe në vitin 2014 është dhënë një leje për një uzinë tjetër, referuar tendencës në rritje për këtë produkt i kërkuar në tregun botëror për industrinë e çelikut, industrinë e bojërave etj. Ecuria në zhvillimin e kësaj industrie duhet të orientohen në aplikimin e teknikave bashkëkohore në lidhje me shfrytëzimin efikas të lëndës parë, kursimit të energjisë elektrike e lëndës djegëse, futjen e skemave bashkëkohore të pasurimit, në rritjen e shfrytëzimit të kondicioneve më të varfra, si dhe skema optimale për pastrimin e gazeve, kraahas shfrytëzimit me kapacitete optimale i objekteve aktuale, duke përmirësuar treguesit e rekuperimit të metalit nga lënda e parë.

Nisur nga kërkesat, mendohet se brënda vitit 2017 të rritet prodhimi i ferro kromit me 30 – 50 % krahasuar me prodhimin aktual, me një kontribut në eksport, PBB, si dhe punësim. Prioritet në të ardhmen mbetet nxitja e investimeve që shërbejnë për futjen në qarkullim të mineraleve më të varfëra (e rendit 10 – 12 % Cr_2O_3), duke aplikuar teknologji pasurimi bashkëkohore përballë kërkesave në rritje për krom.

Galvanizimi

Ky proces industrial mbetet një prioritet si një aktivitet me të ardhme në lidhje me mbrojtjen e produkteve prej metaleve nga korrozioni. Për këtë kërkohet një sinkronizim midis industrisë së përpunimit të metaleve që disa prej këtyre prodhimeve të cilat ekspozohen ndaj agentëve korodues, të kalojnë në veshjen mbrojtëse me metal, siç është edhe zinku apo elementë të tjerë.

Industria e përpunimit të mineraleve jo metalore

Industria e prodhimit të çimentos Kjo dege e industrisë ka arritur të sigurojë një kapacitet prodhimi optimal për vendin tonë, dhe objektivi kryesor duhet të përqendrohet në maksimizimin

e vlerave të aseteve e kapaciteteve aktuale, duke punuar për produkte të markave të cilat deri tani importohen, përmirësim të cilësisë së produktit, e ruajtjen e mjedisit (si një industri me potencial ndotës) nga gazet serë. Zbatimi i direktivave të BE-se për industrinë e çimentos si dhe aplikimi i BAT (Best available techniques) në investime të kësaj industrie, shoqëruar me planet e rehabilitimit të karrierave të lëndës parë të shfrytëzuar mbeten kërkesa parësore në vazhdimësi. Prodhimi i çimentos parashikohet një kontributor i rëndësishëm në eksport e rritjen e PBB.

Industria e prodhimit të tullave e tjegullave

Prioriteti kryesor mbetet konsolidimi i kapaciteteve aktuale, rritje e cilësisë së produkteve për të qenë konkurrues në tregun vendas edhe atë rajonal. Të synohet që brenda një periudhe 5 vjeçare të realizojnë ndërhyrjet e duhura në skemën aktuale teknologjike për zbatimin e direktivave të BE-së për prodhimet qeramike si dhe aplikimin e teknikave të mundëshme të avancuara që sjellin punë me kursim energjie, lëndë djegëse e ulin impaktin në mjedis dhe shëndet.

Prodhim gëlqereje, fino, allçi etj.

Ndër kërkesat kryesore ndaj investitorëve që kërkojnë të investojnë për prodhimin e gëlqeres mbetet aplikimi i teknologjive bashkëkohore, që sigurojnë jo vetëm produkt cilësor por edhe ulje të shkallës së ndikimit në mjedis, rehabilitim korrekt i karrierave etj.

Prodhime qeramike në tërësi dhe qelqit

Prodhimet e qeramikës, janë akoma në nivelin e artizanatit, si rrjedhojë, kërkohet promovim i burimeve natyrore, mbështetje të investitorëve aktuale, si dhe nxitje e atyre me eksperiencë, për të kaluar në skema prodhimi bashkëkohore për produkte cilësore e kosto konkurruese, rritje e gamës së tyre.

Materialet kompozite

Sot në botë ka një përhapje të madhe prodhimi i materialeve kompozite (kombinacione të metaleve me përbërës të tjerë, si dhe përzjerje të plastikave etj.), të cilat kanë fushë të madhe përdorimi, në konstruksione etj. Kjo degë kërkon doemos nxitje e vlerësim në të ardhmen duke përgatitur edhe vlerësime tekniko-ekonomike për situatën e mundësia për rritjen e përhapjes së këtyre prodhimeve edhe në vendin tonë.

Industria Tekstile – konfeksione

Kjo industri ka ecur mirë, e tendenca në të ardhmen mbetet skema e punës me mall porositësi (perpunim aktiv), sepse ka interes prej forcës së punës e cila akoma në vendin tonë është e lirë, krahas përfitimit të një eksperience prej 20 vitesh. Rivlerësim mbetet rast pas rasti për mundësi rritje kontributi në PBB-në e vendit, krahas nevojave për kushte e mjedise pune më optimale si dhe skema teknologjie bashkëkohore të cilat sjellin uljen e konsumit të energjisë, lëndës djegëse, e sidomos impaktin në shëndet. Tendenca duhet të jetë arritje e daljes direkt në treg e kompanive shqiptare të pavarura nga kompanitë “Mëmë”, si një instrument ndikues në rritjen e nivelit të ardhurave në buxhet.

Industria lëkurë – këpucëve

Edhe kjo industri është fokusuar e tipit perpunimit aktiv, e cila është konsoliduar e madje produktet made in Albania janë potenciale në tregun rajonal e më gjërë. Megjithë një shpërndarje rajonale e subjekteve të saj, vazhdon të jetë e përqendruar më shumë në rajonin Tiranë-Durrës. Është kontributore kryesore në eksport, por kërkohet të ndikohet në rritjen e efektivitetit në PBB-inë e vendit. Meqenëse lënda e parë lëkurë, kryesisht sigurohet nga importi, ndërkohë që vendi disponon mundësi perpunimi lëkure për përdorim, prioritet do të jetë një vlerësim tekniko-ekonomik për ciklin e plotë nga perpunim lëkure deri në produktet finale.

MEI për këtë qellim ka përgatitur detyrë studimore për vlerësim më të plotë tekniko-ekonomik të kësaj industrie në bashkërendim me qarqet akademike dhe AIDA, për të rritur shkallën e perpunimit në vend të lëkurës. Edhe në këtë industri në vazhdimësi, prioritet do të jetë investimi në aplikim të teknikave bashkëkohore në sistemin e ventilimit e pastrimit të mjediseve të punës por edhe uljen e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë, si dhe mundësia e shpëputjes së vartësisë nga kompanitë “Mëmë” duke dalë direkt në treg.

Industria e drurit, mobilieve dhe letrës

Zhvillimi i industrisë së drurit dhe mobilieve në të ardhmen duhet të ketë si objektiv kryesor realizimin e ndryshimeve cilësore për të qenë më e suksesshme me prodhimet e saj si në tregun vendas ashtu dhe në eksport. Kjo industri duhet orientuar për zgjerimin e gamës së artikujve me dru masiv, mjaft të kërkuara nga tregu i huaj. Sa i takon industrisë së letrës, kjo është fokusuar në riciklimin e mbetjeve duke prodhuar kartonin, si dhe disa produkte për letër higjienike, ambalazhi etj. Aktivizimi i këtij sektori mbi bazën e përdorimit të lëndës së parë në

vend ka vështirësi edhe për faktin se periudha e tranzicionit solli dëmtim masiv të pyjeve, krahas shkatërrimit të ish objekteve që realizonin prodhimin e letrës.

Një element që rrit shkallën e konkureshmërise rajonale, ndër të tjera është nxitja për mundësi riorganizimi në njësi prodhimi më të mëdha bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera, modeli perqendrimeve, në mënyrë që të rritet efikasiteti i kësaj dege të industrisë, në plotësimin e nevojave të vendit por edhe konkurrimit në tregun rajonal.

Industria kimike

Industria kimike këto vite është orientuar në prodhimin e disa artikujve si detergjentë, bojra, polisterol e regjenerime vajrash lubrifikante, të disa gazeve industriale, kryesisht për tregun vendas, sepse akoma kjo industri nuk është në ato nivele që të konkurrojnë tregun rajonal e më gjërë. Kjo degë e industrisë pothuajse bazohet në lëndën e parë të importit, ndërsa elemente të tjerë që lidhen me ambalazhim sigurohen nga subjektet vendase. Kontributi në PBB e eksport është akoma në nivele të ulëta, sepse zhvillimi i saj kërkon një teknologji më bashkëkohore si dhe profesioniste të përgatitur.

Në të ardhmen kjo degë akoma mbetet në nivele të tilla me një tendence rritje të ulet, përballë rritjes të kërkesave që burojnë nga direktivat e BE-se për prodhimet kimike organike e inorganike së bashku me nevojën për të aplikuar teknikat më të mira në shërbim të uljes së impaktit në mjedis, shëndet, dhe rritjen e shkallës së sigurisë për parandalimin e aksidenteve industriale.

Industria e gomë-plastikës

Industria e gomë-plastikës, është akoma në fillimet e saj, duke patur parasysh se kryesisht kjo është fokusuar në punë me lëndë të parë importi dhe riciklim mbetjesh. Produktet prej gome janë në nivele të ulëta, kjo edhe për faktin se deri tani nuk ka patur ndonjë interesim specifik nga investitorë si vendas edhe të huaj.

Në të ardhmen fokusi për këtë industri do të jetë promovimi dhe nxitja e biznesit për rritjen e artikujve prej gome, si gomina për sektorët e industrisë mekanike e shërbimit të automjeteve etj., ndërsa prodhimet e plastikës të konkurrojnë duke realizuar produkte më cilësore e të sigurta për të ulur impaktin në shëndet dhe mjedis.

Industria e punimit të metaleve

Industria mekanike përfaqësohet kryesisht nga subjekte që ushtrojnë aktivitetin e përpunimit të produkteve metalike, disa shërbimeve dhe prodhimeve për nevoja të tregut vendas, e fragmentuar për shkak të numrit të madh të tyre. Natyrisht me një avantazh në lidhje me reagimin e shpejtë ndaj kërkesave të tregut por nga ana tjetër paraqet vështirësi në lidhje me sigurimin e burimeve të financimit dhe optimizmin e kostove të prodhimit për konkurrim në treg rajonal. Zhvillimi i saj është i kushtëzuar në radhë të parë nga zhvillimi i infrastrukturës dhe i ndërtimit.

Në të ardhmen kjo dege duhet të mbaje parasysh jo vetëm kushtet lokale por edhe tendencat e përgjithshme të zhvillimit të saj në kontekstin evropian, duke siguruar cilësi të larte prodhimi e shërbimi. Një sfidë mbetet nxitja për arsimimin teknik dhe formimin profesional i të rinjve për të pasur si në sasi ashtu në cilësi punëtorë të specializuar dhe teknike e inxhinierë të kualifikuar në fushën e punimit të metaleve.

Industria e prodhimit të pajisjeve elektrike

Kjo industri është në nivele të ulëta, subjektet operuese punojnë kryesisht me mall porositësi duke realizuar vetëm montime, pajisje të tilla vetiake tharëse flokësh, transformatorë të vegjël e prodhime të tjera.

Në vazhdimësi kërkohet promovim e bashkërendim me sektorët e tjerë përdorues të pajisjeve elektrike, duke testuar tregun vendas që të rritet gama e artikujve si elektromotorë, aksesore që shërbejnë për instalime të brendshme elektrike etj.

Industria e grumbullimit të mbetjeve dhe riciklimi.

Akoma një pjesë e madhe e mbetjeve metalike (perveç çelikut që përpunohet në vend) dalin të papërpunuara në eksport, duke mos arritur maksimizim të vlerës së tyre. Drejtimi kryesor për rritjen e efikasitetit të maksimizimit të vlerës së mbetjeve metalike, plastike, drurit e letrës, do të fokusohet në ndihmën me instrumente rregullatore të tilla që të stimulojnë përpunimin në vend deri në produkte finale, sidomos në ato raste kur ekziston edhe një infrastrukturë e tillë.

Në të ardhmen kjo industri duhet stimuluar që të rrisë shkallën e grumbullimit të mbetjeve si burime të riciklimit duke kaluar nga rreth 30 % sot deri 70 – 75 % brënda një periudhe 5 – 6 vjeçare, si një rrugë efikase që realizon jo vetëm pastrimin e mjedisit prej mbetjeve, por siguron produkte apo gjysme produkte me kosto më të ulët se kursen energji, lëndë djegëse etj. me mpakt në ekonomi por edhe mjedis. Vëmendje do të përqendrohet në orientimin por edhe detyrimin e aplikimit të skemave teknologjike të riciklimit nëpërmjet teknikave më të mira që sigurojnë parametrat e duhur mjedisore e uljen e ndikimit në shëndet. Një ide që duhet të stimulohet në të ardhmen është bashkërendimi me operatore prodhues që përdorin edhe lëndë djegëse si industria e çimentos etj. për të përdorur si burim djegie disa mbetje nga tekstilet, druri etj., por natyrisht mbetjet fundore pas riciklimit, me një kontroll sigurie nga përdoruesit për sisteme bashkëkohorë pastrimi gazesh e ujërash. Politikat mbështetëse që nxisin ecurinë e kësaj skeme mbeten në qendër të vëmendjes, për të siguruar një ndarje në burim të mbetjeve dhe miradministrim në funksion jo vetëm të mjedisit por edhe si burime potenciale për përfitim produktesh konkurruese. Këto prioritete të trajtuara në mënyre të koncentruar për secilën degë të industrisë, siç cituam në interpretimet e secilës, do të ndiqen duke angazhuar institucionet e vartësisë, e sidomos bashkëpunimin me biznesin, qarqet akademike, AIDA dhe institucione të tjera shtetërore që kanë rol në nxitjen e zhvillimin e sektorëve prioritar në industrinë jo ushqimore. Një pjesë e tyre kanë filluar paralel me hartimin e këtij dokumenti dhe të tjerat programohen në planin e veprimeve pjesë e këtij dokumenti.

SHTOJCA

Të dhëna për kontributin në PBB

Te dhena per kontributin ne PBB per disa dege te industrise Jo ushqimore

milion leke

Emertimi	VITET					
	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Prodhimi i tekstileve, veshjeve; industria e lëkurës dhe këpucëve	14,394	17,177	19,747	17,446	19,347	20.507
Prodhimi i produkteve prej kauçuku, plastike dhe produkte të tjera minerale	11,587	12,525	13,32	11,384	11,703	11.863
Prodhimi i produkteve metalike dhe me bazë metalike përveç makinerive	9,417	11,497	12,12	10,726	12,287	12.150
Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve	2,072	1,637	1,665	1,522	1,887	1.368
Të tjera industri prodhuese, riparime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve	4,113	4,365	4,876	4,4	4,518	4.938
Shuma ind.joushqimore	41,583	47,201	51,778	45,478	49,742	50.826
PBB me çmimet e tregut	1,143,936	1,239,645	1,300,624	1,332,811	1,350,555	1.400.549

Shenim: per 2014 jane te dhëna paraprake nga INSTAT.

Për një ide mbi eksportin sipas degëve të industrisë Jo Ushqimore paraqesim disa të dhëna

Të dhëna për eksportin e disa degëve të industrisë jo ushqimore 2010 – 2015(në mln lekë). Burimi: INSTAT

Emertimi	V. 2010	2011	2012	2013	2014	2015
Produkte kimike dhe plastike	1,743	2,834	2,026	2,887	3,394	3.961
Produkte lekure dhe artikuj lekure	2,567	2,926	2,773	3,195	3,076	2.897
Prodhimi druri dhe letre	4,796	4,558	5,353	8,000	9,181	8.336
Prodhime Tekstile, kepuce	55,646	64,106	62,093	69,367	85,936	90.091
Prodhime material ndërtimi dhe metale	32,339	41,303	40,220	36,191	37,103	35.280
Makineri e pjesë këmbimi	6,730	7,750	7,639	8,246	9,235	10.789
Shuma ind.Joushqimore	103,821	123,477	120,104	127,886	147,925	151.354
Industri dhe aktivitete të tjera ekonomike	57.748	73.420	92.926	118.505	107.834	91.829
Totali	161,549	196,897	213,030	246,391	255,759	243.183

Ne tabelën sipër, janë venë vetëm degët e ind. Jo ushqimore dhe totali për të krijuar idenë e kontributit të kësaj industrie, ku bie në sy ajo e Këpucë-konfeksioneve dhe materiale ndërtimi dhe metale, por edhe rënie e këtyre të fundit kryesisht nga rënie e tregut vendas në ndërtime.

Njëkohësisht në peshën totale në eksport produktet e kësaj industrie zënë rreth 58 % të saj.

Struktura e Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik (ne %). Burimi: INSTAT

Kodi	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	Vitet						
			2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
A1	1-3	Bujqësi, pyje dhe peshkim	16.84	16.79	17.96	18.23	17.77	19.63	19.99
A2	5-9	Industria nxjerrëse	1.78	1.38	2.35	3.45	4.52	4.93	5.34
A3	10-12	Prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit	0.79	1.79	0.85	0.86	0.77	0.69	0.63
A4	13-15	Prodhimi i tekstileve, veshjeve; industria e lëkurës dhe këpucëve	1.19	1.26	1.39	1.52	1.31	1.43	1.46
A5	16-18	Prodhimi i produkteve prej druri, letre dhe të shtypshkrimit	0.28	0.40	0.56	0.53	0.47	0.39	0.39
A6	19	Përpunimi i koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar	0.32	0.20	0.11	0.14	(0.16)	(0.02)	(0.02)
A7	20.21	Industria kimike dhe e produkteve farmaceutike	0.13	0.18	0.12	0.15	0.13	0.12	0.13
A8	22.23	Prodhimi i produkteve prej kauçuku, plastike dhe produkte të tjera minerale	0.88	1.01	1.01	1.02	0.85	0.87	0.85
A9	24.25	Prodhimi i produkteve metalike dhe me bazë metalike përveç makinerive	0.92	0.82	0.93	0.93	0.80	0.91	0.87
A10	26-28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve	0.16	0.18	0.13	0.13	0.11	0.14	0.10
A11	31-33	Të tjera industri prodhuese, riparime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve	0.33	0.36	0.35	0.37	0.33	0.33	0.35
A12	35	Energjia elektrike, furnizimi me gas, avull dhe ajër të kondicionuar	1.88	2.12	3.36	1.82	1.67	2.06	1.85
A13	36	Prodhimi dhe furnizimi me ujë	0.33	0.33	0.42	0.41	0.37	0.37	0.34
A14	37-39	Kanalizime dhe menaxhimi e trajtimi i mbetjeve	0.35	0.42	0.43	0.43	0.35	0.37	0.33
A15	41-43	Ndërtimi	15.82	14.96	12.93	12.72	11.39	10.41	9.29
A16	45	Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	0.52	0.62	0.63	0.59	0.59	0.56	0.57 0.57
A17	46	Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorçikletave	6.30	5.98	6.02	5.91	6.27	6.31	6.57
A18	47	Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së	4.47	4.45	3.96	4.16	3.91	4.02	3.98

		automjeteve dhe motorçikletave							
A19	49	Transporti tokësor dhe me tubacione	1.83	1.99	2.01	2.13	2.00	1.64	1.56
A20	50-52	Transporti uhor, ajror dhe magazinimi	1.10	1.21	1.38	1.57	1.82	1.27	1.19
A21	53	Aktivitetet të postës dhe korrierës	0.42	0.40	0.40	0.40	0.40	0.35	0.38
A22	55-56	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	1.91	2.04	2.09	1.90	1.84	1.71	1.63
A23	58-60	Aktivitetet të publikimit, audiovizuale dhe transmetimit	0.70	0.77	0.75	0.89	0.82	0.73	0.71
A24	61	Telekomunikimi	4.09	3.76	2.75	2.36	2.04	1.84	1.65
A25	62-63	IT dhe të tjera shërbime informacioni	0.10	0.12	0.12	0.13	0.27	0.19	0.23
A26	64-66	Aktivitetet financiare dhe të siguracionit	2.81	2.38	2.39	2.57	2.41	2.25	2.54
A27	68	Aktivitetet të Real estate (Dhënies-Marrjes me qira)	6.81	6.52	6.16	6.03	5.99	6.40	6.18
A28	69-71	Aktivitetet ligjore dhe kontabiliteti, drejtimi, arkitekture dhe inxhinierie	1.19	1.39	1.33	1.26	1.66	1.78	1.91
A29	72-75	Kërkim dhe zhvillim shkencor dhe aktivitetet të tjera profesionale, shkencore e teknike	0.41	0.55	0.46	0.48	0.46	0.41	0.38
A30	77-82	Aktivitetet administrative dhe shërbime mbështetëse	1.13	0.96	1.00	1.18	1.77	2.22	2.78
A31	84	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyruar social	3.72	3.99	3.93	3.96	4.03	4.00	4.08
A32	85	Arsimi	3.48	3.73	3.79	3.90	4.33	4.54	4.35
A33	86-88	Shëndetësia dhe aktivitetet të punës sociale	1.88	2.23	2.35	2.43	2.50	2.58	2.70
A34	90-93	Arte, argëtim dhe çlodhje	0.85	0.86	0.98	1.07	0.89	0.75	1.00
A35	94-98	Aktivitetet të tjera shërbimi dhe aktivitetet të familionjeve	0.99	1.27	1.51	1.34	0.96	1.07	1.04
		Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë	86.70	86.53	86.92	86.97	86.64	87.24	87.33
		Taksa mbi produktet	13.52	13.63	13.22	13.79	13.47	13.01	13.10
		Subvencionet mbi produkte	(0.22)	(0.16)	(0.14)	(0.76)	(0.11)	(0.25)	(0.43)
		PBB ME ÇMIMET E TREGUT	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Viti 2014 vleresim paraprak Burimi INSTAT									

Kontributi i industrisë jo ushqimore varion 3,62 deri 4,17 % nivele akoma te ulëta krahasuar me vende te rajonit e cila është mbi 8 %.

Për një ide më të plotë me poshtë paraqesim një shpërndarje rajonale të subjekteve që janë evidentuar në QKL (tashmë QKB) për paisje me leje mjedisore deri 2015

Tabela me të dhëna për shpërndarjen e subjekteve sipas qarqeve e rivlerësuar me të dhënat e siguruar nga QKL (për paisje me leje mjedisore), periudha deri në fund 2015.

Nr.	Qarku (rrethi)	Nr. Subjekteve	% ndaj totalit
	Totali	1315	100.00
1	Berat	80	6.08
1.1	Berat	75	5.70
1.2	Kuçove	3	0.23
1.3	Skrapar	2	0.15
2	Dibër	16	1.22
2.1	Dibër	10	0.76
2.2	Mat	3	0.23
2.3	Bulqize	3	0.23
3	Durrës	262	19.92
3.1	Durrës	220	16.73
3.2	Kruje	42	3.19
4	Elbasan	127	9.66
4.1	Elbasan	122	9.27
4.2	Librazhd	3	0.23
4.3	Gramsh	1	0.08
4.4	Peqin	1	0.08
5	Fier	75	5.70
5.1	Fier	51	3.88
5.2	Lushnje	22	1.67
5.3	Mallakastër	2	0.15
6	Gjirokastër	61	4.64
6.1	Gjirokastër	56	4.26
6.2	Tepelene	2	0.15
6.3	Përmet	3	0.23
7	Korçe	131	9.96
7.1	Korçe	123	9.35
7.2	Pogradec	4	0.3
7.3	Devoll	1	0.08
7.4	Erseke	3	0.23
8	Kukës	6	0.46
8.1	Kukës	4	0.3

8.2	Has	1	0.08
8.3	Tropoje	1	0.08
9	Lezhe	70	5.32
9.1	Lezhe	61	4.64
9.2	Mirdite	3	0.23
9.3	Kurbin	6	0.45
10	Shkodër	62	4.71
10	Shkodër	59	4.48
10	Malësie e Madhe	2	0.15
10	Puke	1	0.08
11	Tirane	365	27.77
11	Tirane	352	26.77
11	Kavaje	13	1,00
12	Vlora	60	4.56
12	Vlore	50	3.80
12	Sarande	7	0.53
12	Delvine	3	0.23

Edhe nga kjo paraqitje tabelare duket se pesha kryesore në veprimtarinë e industrisë Jo Ushqimore e ka Tirana me rreth 28 % të numrit total të subjekteve, e pasuar me Durrësin, Korçën dhe Elbasanin, ndërsa duhet theksuar se nivel i ulët është në qarkun Kukës dhe Dibër.

Ky vlerësim rezulton referuar informacionit të siguruar prej QKL në lidhje me veprimtaritë e paisura me leje mjedisore, pasi është e vështirë të sigurohej nga QKR, sepse janë të regjistruara si shoqëri ku kanë në aktivitetin e tyre disa lloj veprimtarish edhe tregëti etj.(tashmë **2016 QKB**).

Kjo strukturë flet për një zhvillim disi jo të mirëorientuar e mbi bazën e planeve rregulluese zhvillimore në vite, natyrisht duke shfrytëzuar një zgjatje të tranzicionit në vendin tonë.

Rrjedhoje e kësaj tabloje kërkohet që të mbahen në konsideratë dhe orjentohej politika zhvillimore në këto zona aq me tepër kur në veri – lindje janë edhe disa pasuri natyrore të cilat kanë nevojë për mireadministrim duke krijuar kushtet dhe mundësitë për rritjen e interesit të investitorëve serioz e strategjik për maksimizimin e këtyre pasurive nëpërmjet rritjes së shkallës së përpunimit.

Një politike tjetër mbështetëse mendojmë se duhet të jetë orientimi dhe ofrimi në këto rajone i disa investimeve që lidhen me tekstil-konfeksione apo lëkurë – këpuca tipi PERPUNIMIT AKTIV, për zbutje punësimi, por një mase tjetër zbutëse, është përmirësimi i shpërndarjes së të ardhurave që mund të sigurohen nga renta e burimeve natyrore duke kaluar tek organet vendore, për politika zhvillimore rajonale në disa sektorë që lidhen me potencialet njerëzore e burimet natyrore të zonës.

Plani i veprimeve, kostimi dhe indikatorët për realizimin e objektivave kryesore të dokumentit të Politikave për Industrinë

Jo Ushqimore

Tabela 1: Kostimi i zbatimit të dokumentit strategjik sipas objektivave 2016-2025 dhe kostimi total ⁽⁴⁾

Objektivat strategjike dhe nënobjektivat të mbuluara nga dokumenti strategjik	Kosto Totale (të percaktohet në milion Lek)	Financimi		Hendeku Financiar	Komente për objektivat me hendek financiar
		Buxhet	donatorët		
TOTALI	1427,7	988,2	439,5 Do te kerkohet nga donatoret		Per ekspertize,projektimi e zbatimi por sidoemos per asgjesim kimikatesh te rrezikshme do te kerkohet te sigurohen donator
Objektivi 1 -Krijim te një baze të dhënash informatike dhe përditësimit periodik sipas degeve të industrisë.					Nuk kerkohen financime shtese pasi kryhen me strukturat perkatese shteterore
Ngritje e nje nivel bashkerendimi me INSTAT, QKB, etj					
Pergatitje regjistri te subjekteve qe operojne ne industrine jo ushqimore sipas burimeve nga QKB per leje mjedisore					

Administrim informacioni e permiresim i vazhdueshem ne funksion te orjentimit per politika e prioritete per industrine					
Objektivi 2 -Nepërmjet një administrimi më efikas të ish objekteve industriale, dhe një rehabilitimi pjesor të tyre, të realizojmë brënda vitit 2018 transferimin tek administrimi privat i aseteve të mbetura, duke siguruar maksimizim të vlerës së mbetur e orientuar përdorimin e tyre për destinacione veprimtari prodhuese industriale apo shërbime të tjera me interes ekonomik.	815	629	186 do te kerkohet se eshte programuar ne kerkesat e Pipeline project	Kerkohen edhe donacione per diferencen	
Te synohet finalizimi i privatizimit i aseteve te mbetura ne ish objekte industrial Brenda vitit 2018	113	113			
Rehabilitim i disa territoreve ish industrial me synim maksimizimin e vleres dhe promovim per zhvillim industrial	700	514			
Promovimi i këtyre zonave per zhvillime industrie	2	2			
Objektivi 3 -Te përgatitet infrastruktura e duhur me sigurim ekspertize sipas modeleve të vendeve të rajonit, dhe në bashkërendim me institucione të tjera të punohet për krijimin e një grupimi në një	4	4			

prej degëve të fushës së industrisë. Paralelisht do të përmirësohet kuadri ligjor rregullator në shërbim të këtij organizimi të bizneseve të vogla në njësi më të mëdha.))					
Te sigurohet ekspertize e huaj nga vendet e rajonit apo fqinje për ideimin e krijimit të Cluster-ave	3	3			
Te synohet që nepermjet ekspertizes të arrihet në kushtet për krijim të një Cluster-i për një dege të industrisë	1	1			
Objektivi 4 -Te nxitim e mbështetim rritjen e shkallës së përpunimit të disa burimeve potenciale natyrore si kromi, bakri, kuarcitet, nikel-silikatet apo edhe aseteve të tjera si lëkura (për përpunim), së bashku edhe me riciklimin e mbetjeve, e sidomos të atyre metalike, për të realizuar përpunimin e plotë deri në produkt final.	8	6,5	1,5		Donacion nga UNDP
Te mbështeten projektet e ndryshme zhvillimore në industrinë përpunuese të kromit, pasurimi dhe shkrirja për prodhim koncentrat dhe ferrokrom					
Te vlerësohet ecuria e industrisë së bakrit, efektiviteti aktual, me synim përmirësimin					

e administrimit te asteve dhe mireperdorimit te burimeve natyrore					
Te vleresohen ecuria e industries se lekure kepuceve, kuarciteve, nikel-silikateve, qeramikes etj si dhe orjentohen per rritje shkalle perpunimi ne vend I asetave e burimeve tona natyrore	8	6,5	1,5		
Objektivi 5 (Rritim peshën e industrisë jo ushqimore në PBB-së në rreth 6 -7 % brënda vitit 2020, nga 4 – 4, 5 % në vitin 2015					
Venie ne shfrytezim e 6 fabrikave te reja te pasurimit per kromin, 2 per bakrin e pritshmeri per 2 te tjera tek Kuarcitet e Nikel-Silikatet Venie ne shfrytezim e nje Uzine Ferrokromi deri 2020 e me pas edhe nje tjeter deri 2025				Mbeshtetja e strukturave perkatase per ecuri procedurash deri ne venien ne shfrytezim behet pa kosto shtese te administrates	Nuk ka kosto financiare nga buxheti por jane investime te privatit
Pritshmeri per permiresim menaxhimi nga investor serioz e Uzines se Telave dhe kablllove Shkoder Pritshmeri per shprehje interesi dhe perpunim ne Uzinen e Rafinimit te Bakrit Rubik e mbetjeve metalike te bakrit, tunxhit, bronzit etj					

Rritje e efektivitetit dhe kontribut ne eksport e GDP e ind. Mat.Ndertimi, Fason etj					
Objektivi 6 -Te përmirësojmë monitorimin e veprimtarive industriale (objekte të dhëna me koncesion apo qira simbolike 1 euro etj), sidomos të atyre që përpunojnë burime natyrore, për të siguruar parametra teknike e teknologjikë bashkëkohor si dhe shmangur evazionin në lidhje me mirëadministrimin e aseteve të dhëna për shfrytëzim)	30	30			
Rivleresim i ecurise se deritanishme e disa koncensioneve ne industrine perpunuese te bakrit me synim mireadministrimin dhe zhvillimin e duhur ne sherbim te nevojave te ekonomise					
Te rritet niveli I kontrollit per ecurine e kontratave me qira 1 euro per terriore e objekte prone shtet ne fushen e industrise					
Objektivi 7 -Bashkërendim me strukturat ligjore, shoqërinë civile si pjesë e rëndësishme në dhënien e mendimeve oponentë, me synim nxitje e mbështetje për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në sektorin prodhues, forcimi i bashkëpunimit midis ndërmarrjeve dhe institucioneve të arsimit të lartë publik me	2	2			

synim rritjen e numrit të projekteve të përbashkët ndërmjet sektorit publik të arsimit të lartë dhe sektorit privat. Tërheqje mendimi oponent prej këtyre strukturave për studime e projekte specifike, përpara etapave të tjera për miratim.					
Rritje e nivelit të bashkepunimit midis subjekteve prodhuese, institucioneve qendrore dhe qarqeve akademike për studime, dhe vleresime opONENTE në fusha të ndryshme të industrisë	1	1			
Bashkepunim me subjektet dhe përfaqësues të shoqatave të tyre për marrje mendimesh dhe problematika të ndryshme me interes të zhvillimit të veprimtarive të tyre ekonomike	1	1			
○ Objektivi 8-Përmirësimi i rolit rregullator të institucioneve përgjegjëse për industrinë, dhe nivel më i lartë bashkërendimi me strukturat e tjera politikbërëse në fushën e mjedisit etj, për të orientuar më mirë politikat zhvillimore që lidhen me	568,7 milion Lekë nga <u>ku 1,8 mil Euro</u> projekt për asgjësim kimikatesh të rrezikshme	316,7	Pjesa prej 1,8 milion euro (252 mil.leke) është në Projektet	Do të kerkohen donator se bashku me ekspertizë duhur për projektim dhe zbatim	Ka problem sepse kerkohet ekspertizë e huaj për projektin dhe zbatimin e tij për asgjësim, prandaj nuk mund të programohet nga buxheti

industrinë jo ushqimore, të cilat sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm e miqësor me mjedisin.			strategjike Pipeline project Do te kerkohen donatore		
○ Evidentim i kimikateve gjëndje në ish objekte industriale dhe transferim i tyre në Qendrën e Grumbullimit e trajtimit të kimikateve të rrezikshme në Elbasan	200	200			
○ Te kërkohet ekspertize e huaj per mundësi financimi dhe zbatimi projekt per asgjësim te kimikateve te rrezikshme gjendje ne depon përkatëse te Elbasanit	252 (ose 1,8 milion euro)	-----	Do te kerkohen ekspertiza dhe donator		Ka nevoja per ekspertize dhe donacione si ne pergatitje projekti dhe investim e zbatim, sepse vendi yne nuk disponon te tilla
○ Te bashkerendohet me disa subjekte kryesore potencialisht ndotese ne mjedis per te mundesuar aplikimin gradual te BAT per ruajtje mjedisi etj	1	1			

○ Te sugjerohet strukturave politikberese mjedisore nevoja per ndertimin e Landfilleve te mbetjeve te rrezikshme per administrimin e mbetjeve te krijuara nga industria sipas rajoneve te vendit.				Nuk ka nevoje per mbeshtetje financiare kjo procedure iniciuese e propozuese sepse realizohet nga stafi I MEI	
○ Monitorim I dy landfilleve me mbetje te rrezikshme ne Ish Azotik Fier dhe Sode	60,7	60,7			
• Pershtatje e legjislacionit per Sigurine e paisjeve nen presion dhe atyre elektrike si dhe pergatitje e disa Rregullave teknike per makinerite e paisjet etj				Pa ndonje mbeshteje buxhetore sepse kryhet nga strukturat e MEI	
○ Krijim i nje strukture ne AKBN si njesi fokale per ekspertiza e monitorime ne vartesi te prioriteteve zhvillimore te sektoreve te ndryshem	55	55			

⁽⁴⁾ **Megjithese** Vlera e kerkuar prej 1,8 milion euro, per ekspertize te huaj per pergatitje projekti deri ne realizim investimi e zbatim te tij per asgjesim kimikatesh te rrezikshme, dhe perben hendek financiar, projekti ne fjale eshte pjese e paketes kombetare e projekteve strategjike.

Tabela 2: Tabela e treguesve/indikatorëve për monitorimin e dokumentit strategjik për industrinë joushqimore .⁽⁵⁾

Objektivi 1 (Krijim te një baze të dhënash informatike dhe përditësimit periodik sipas degeve të industrise)														
Nr .	Përshkrimi i treguesve	Njësia (% /numri)	Intitucioni përgjegjës	Viti bazë 2014	Synimi Viti 2016	Synimi Viti 2017	Synimi Viti 2018	Synimi Viti 2019	Synimi Viti 2020	Synimi Viti 2021	Synimi Viti 2022	Synimi Viti 2023	Synimi Viti 2024	Synimi Viti 2025
1	Krijim te regjistrat te subjekteve te licensuara qe ushtrojne veprimtari industrial jo ushqimore e permiresim cdo vit i tij	Njesi	Drejtoria e Pol.Zhvill.Industrise ne bashkerendim me INSTAT, QKB etj	-	1	Rinovi m cdo vit								
Objektivi 2 (Nepërmjet një administrimi më efikas të ish objekteve industriale, dhe një rehabilitimi pjesor të tyre, të realizojmë brënda vitit 2018 transferimin tek administrimi privat i aseteve të mbetura, duke siguruar maksimizim të vlerës së mbetur e orientuar përdorimin e tyre për destinacione veprimtari prodhuese industriale apo shërbime të tjera me interes ekonomik.)														
2	Ndermarrje te likujduara e transferuara	Numer/ njesi	Drejtoria e Pol.Zhvill.Industrise Dr.Privatizimit ne bashkerendim me MZHETTS	15	8	6	3	--						
3	Rehabilitim dhe ofrim per zona zhvillimi industriale	" "	Dr. Pol.Zhvill.Ind. Dr.Privatizimit dhe Koncensioneve, Dr.Juridike me administratoret	4		2	2							

			e ndermarrjeve e shoqerive											
4	Promovim dhe synim per kalim ne administrim dhe zhvillim i ketyre zonave per veprimtari industriale	“ “	Dr. Pol.Zhvill.Ind. Dr.Privatizimit dhe Koncensioneve, Dr.Juridike ne bashkerendim me AIDA	4				2	2					
5	Monitorim I ecurise se aseteteve te zonave te rehabilituara te dhena per zhvillim veprimtarie industriale	“ “	Dr. Pol.Zhvill.Ind. Dr.Privatizimit							4	4	4	4	4
Objektivi 3 (Te përgatitim infrastrukturen e duhur me sigurim ekspertize sipas modeleve të vendeve të rajonit, dhe në bashkërendim me institucione të tjera të punohet për krijimin e një grupimi në një prej degëve të fushës së industrisë. Paralelisht do të përmirësohet kuadri ligjor rregullator në shërbim të këtij organizimi të bizneseve të vogla në njësi më të mëdha.))														
5	Synim organizimi te nje model veprimtarie Cluster ne nje prej degeve te industries	Numer numer	Dr. Pol.Zhvill.Ind Ne bashkerendim me AIDA, MZHETTS, subjektet e interesuara dhe struktura te tjera si Tatime etj					1						
	Promovim e nxitje te sektoreve te tjere sipas modelit te arritur	Numer	Dr. Pol.Zhvill.Ind Ne bashkerendim						1		1			

8	Pergatitje oferte tekniko tregtare dhe promovim per shprehje interesi te administrimit dhe zhvillimit te asetave dhe burimeve te lira natyrore ne industrine e bakrit. Ndjekie procesi dhe ecurie ne rast zhvillimi pozitiv gjate periudhes		AKBN me Dr.Pol.Zhvill.Ind. Dr.Pol.Zhvill.Minj erave Dr.Privatizimit dhe Koncensioneve Dr.Juridike		1	1								
9	Studim vleresimi tekniko-ekonomik per industrine e Lekure-Kepuceve		Dr.Pol.Zhvill.Ind me AIDA		1									
10	Studime vleresimi tekniko-ekonomik per -a—Ind. Kuarciteve -b-Ind. Nikel – Silikateve -c- Ind.Prodhimeve qeramike e materiale kompozite --d- Per krijim te nje kompanie nga Fason ne kompani 100 % shqiptare ne ind.Lekure-Kepuceve apo ndonje tjeter		Dr.Pol.Zhvill.Ind me qarqe akademike dhe AIDA			1 1			1	1		1		
Objektivi 5 (Rritje e peshës te industrisë jo ushqimore në PPB-së në rreth 6 -7 % brënda vitit 2020, nga 4 – 4, 5 % në vitin 2015) me synim 7 – 9 % ne 2025														
11	Venie ne shfrytezim e 6 fabrikave te reja te pasurimit te kromit deri 2020 dhe pritshmeri per dy te tjera deri 2025 per kromin, si dhe 2 per bakrin	%	Subjektet e interesuara me mbeshtetjen e kerkuar te			0,14	0,07	0,2	0,2		0,2	0,4	0,4	+0,4

[illegible]

	-Ind.Kuarciteve -Ind.Nikel-Silikateve -Ind.qeramike e materiale kompozite		okurimeve			1 1				1	1				
	Organizim anketimi me subjekte te ndryshme te ind. Jo Ushqimore per marrje mendimi per ecuri te veprimtarise prodhese etj	Numer	Drejtoria e Politikave,Zhvillimi te Industrise dhe Standardeve Teknike	1		1		1			1		1		1
	○ Objektivi 8 -Përmirësimi i rolit rregullator te institucioneve përgjegjëse për industrinë, dhe nivel më i lartë bashkërendimi me strukturat e tjera politikbërëse në fushën e mjedisit etj, për të orientuar më mirë politikat zhvillimore që lidhen me industrinë jo ushqimore, të cilat sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm e miqësor me mjedisin.														
21	Transferim i kimikateve te rrezikshme gjendje dhe atyre qe krijohen ne vazhdimësi në Qëndrën e Grumbullimit e trajtimit të kimikateve të rrezikshme në Elbasan	ton	Drejtuesit e ndermarrjeve ne likujdim dhe QKGTK Elbasan	15	85	150	Sasia e re e krijuar	Sasia e re	Sasia e re	Sasia e re	Sasia e re	Sasia e re	Sasia e re	Sasia e re	Sasia e re
22	Sigurim ekspertize te huaj per mundësi financimi dhe zbatimi projekti per asgjësim te kimikateve te rrezikshme gjendje ne depon përkatëse te Elbasanit	Projekt dhe zbatim	Drejtoria e Politikave,Zhvillimi te Industrise dhe Standardeve Teknike dhe Drejtorine e Projekteve dhe Integritimit ne MEI, ne bashkerendim				Projekti		Fillim zbatimi	zbatimi	zbatimi				

			me Min.Mjedisit dhe Mbrojtjes												
	Propozimi tek strukturat politikberese mjedisoreper nevojen e ndertimit te Landfilleve per mbejte te rrezikshme	Numer akti	Drejtoria e Politikave,Zhvilli mit te Industrise dhe Standardeve Teknike			1(Propozimi)									
23	Administrim korekt te landfilleve te mbetjeve te rrezikshme ne ish Azotikun Fier dhe ish Sode PVC Vlore	Numer	Stafet administruese direct te ketyre objekteve nen monitorim te Drejt.Pol.Zhvill. Industrise	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
